



Essential Plan

Në një vështrim të shpejtë

KUSH KUALIFIKOHET?

INDIVIDË QË:

- Janë banorë të New York State
- Mund të përbushin kërkesat për të ardhurat e Essential Plan
- Janë rezidentë të ligjshëm në SHBA
- Janë 19-64 vjeç
- Nuk kualifikohen për "Medicaid" ose "Child Health Plus"
- Nuk kualifikohen për mbulim punëdhënësi dhe mbulime të tjera

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, besimit/fesë, gjinisë, moshës, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.

ÇFARË MBULOHE?

- Kujdes parandalues falas
- Kujdes për pacientë të brendshëm
- Shërbime ambulatorë
- Kujdes neonatal dhe për nënën
- Shërbime emergjence
- Laborator dhe imazheri
- Barna me recetë
- Shërbime rehabilitimi dhe trajtimi
- Shërbime për persona me çrregullime të shëndetit mendor ose të përdorimit të substancave
- Shërbime trajtimi dhe menaxhimi të sëmundjeve kronike

NA KONTAKTONI:

nystateofhealth.ny.gov | 1-855-355-5777 ose TTY 1-800-662-1220

SA KUSHTON ESSENTIAL PLAN?

PRIMET: Primi mujor është \$20 ose \$0 për person, në varësi të të ardhurave.

NDARJA E KOSTOVE: NUK ka **TARIFA TË ZBRITSHME**. Më poshtë paraqiten disa shembuj të niveleve të ndarjes së kostove të Essential Plan.

NDARJA E KOSTOVE PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR	Të ardhura vjetore individuale: nën \$12,490-\$18,735	Të ardhura vjetore individuale: \$18,736-\$24,980
Primi mujor	\$0	\$20
Tarifat e zbritshme vjetore	Nuk ka	Nuk ka
Kujdesi parandalues	Falas	Falas
Vizitë mjeku e kujdesit parësor	\$0	\$15
Vizitë te specialisti	\$0	\$25
Shtrim në spital për pacientë të brendshëm	\$0	\$150
Vizitë shëndetësore e sjelljes për pacientë të jashtëm	\$0	\$15
Vizitë shëndetësore e sjelljes për pacientë të brendshëm për shtrim	\$0	\$150
Sallë emergjence	\$0	\$75
Kujdes urgjent	\$0	\$25
Terapi fizike, terapi ligjërimi, terapi okupacionale	\$0	\$15
NDARJA E KOSTOVE PËR BARNAT ME RECETË	Të ardhura vjetore individuale: nën \$12,490-\$18,735*	Të ardhura vjetore individuale: \$18,736-\$24,980
Të përgjithshme	\$1	\$6
Markë e preferuar	\$3	\$15
Markë jo e preferuar	\$3	\$30

*\$0 për individë me
të ardhura nën \$12,490.

NDARJA E KOSTOVE PËR PËRFITIMET DENTARE DHE OKULISTIKE	Të ardhura vjetore individuale: nën \$12,490-\$18,735	Të ardhura vjetore individuale: \$18,736-\$24,980
Kujdes dentar dhe okulistik	\$0 (të regjistruarit me të ardhura më të ulëta) Mund të blihet për një prim shtesë (të regjistruarit me të ardhura më të larta)	Mund të blihet për një prim shtesë